



Nr. 123/1 Prot  
Dt. 08.02.24

REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 123/1 prot.

Shkodër më 08/02.2024

Lënda: Mbi Vendimin nr. 2, datë 26.01.2024 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës

### KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 24, neni 54, shkronja "n", neni 55, pika 2, neni 64, shkronja "e", të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 21, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përlitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të ndryshuar, Kreu IV, pika 1, të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", i ndryshuar, *shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 2, datë 26.01.2024 "Mbi kriteret për familjet për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për vitin 2024"*.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Majlinda ANGONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KESHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr 02. Date 26 / 01 /2024

Për:

**“Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2024”.**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Në ligjin Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I :**

1. Të miratohen Kriteret Specifike për vitin 2024 mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Këshillit Bashkiak për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike, familjet të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës së pikëzimit.
  1. Familje te varfëra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, që nuk plotësojnë nevojat bazë për jetesë.
  2. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me aftësi të kufizuar/invalid pune.
  3. Familje me shumë fëmijë.
  4. Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme, dhe me probleme sociale.
  5. Persona qe jetojnë te vetëm ,të moshuar, që kanë dhe probleme shendetesore .
  6. Familje me te ardhura te pamjaftueshme që ka në përbërje fëmijë që ndjekin arsimin e lartë.
  7. Familjet që nuk kanë banesë ose jetojnë me qera.
  8. Familje që kanë në përbërje të moshuar, që nuk kanë pension ose e kanë pension minimal.
  9. Kryefamiljare gra të veja apo të divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme.
2. Dokumentat e aplikuesve janë sipas VKM nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Masa e ndihmës ekonomike llogaritet sipas VKM nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Fuqizimit Ekonomik.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**SEKRETARI I KESHILLIT**  
**Ardian ÇELEPIJA**

Miratuar me 22.....vota  
Vota pro 22  
Vota kunder .....  
Vota Abstenim .....  
Zbardhur me date 31/01/2024



**KRYETARI I KESHILLIT**  
**Ervis SHIMAJ**